

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË

P. No. 514/09

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Komunale në Prishtinë, me Trupin Gjykses të përbërë nga:

- 1) Gjykatësi i EULEX-it, Z. Francesco Florit, Kryetar i Trupit Gjykses,
- 2) Gjykatësi i EULEX-it, Z. Ferdinando Buatier de Mongeot, anëtar i Trupit Gjykses,
- 3) Gjykatësja vendore, Znj. Shadije Gërguri, anëtar i Trupit Gjykses,

i asistuar nga processmbajtësi i nënshkruar më poshtë, në lëndën penale kundër:

Tomë Gashi:

Për kryerjen e veprës penale: Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në pajtim me nenin 317, para. 2 lidhur me para. 1 dhe para. 4 të KPK;

Avni Zogiani dhe Lorik Pustina:

Për kryerjen e veprës penale: Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në pajtim me nenin 316 para. 3 lidhur me para. 1 dhe 5 dhe nenin 23 të KPK; dhe

Bekim Mengjiqi:

Për kryerjen e veprës penale: Lëndim i lehtë trupor, në pajtim me nenin 153, para.2 lidhur me para. 1 pika (iii) të KPK

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në prani të Prokurorit Publik, të të akuzuarit, dhe palëve të dëmtuara më 14, 25, 27 dhe 28 maj 2010;

Duke marrë parasysh ndryshimin e aktakuzës të bërë nga Prokurori gjatë seancës së 28 majit 2010;

pas pleqërimit të Trupit Gjykses të mbajtur më 28 maj 2010, bazuar në nenin 390 dhe 391 të KPPK;

shpall këtë:

AKTGJYKIM

Tomë Gashi shpallet fajtor për veprën penale:

Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në pajtim me nenin 317, para. 2 lidhur me para. 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), me përjashtim të rrethanës nga para. 4 i nenit të njëjtë;

Lorik Pustina shpallet fajtor për veprën penale:

Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në pajtim me nenin 316 para. 3 lidhur me para. 1 të KPK, me përjashtim të rrethanës nga para. 5 i nenit të njëjtë;

Bekim Mengjiqi shpallet fajtor për veprën penale:

Lëndim i lehtë trupor, në pajtim me nenin 153 para. 1, pika 4 të KPPK, me përjashtim të rrethanës nga para. 2 i nenit të njëjtë.

Specifikisht

I pandehuri Tomë Gashi

1. Më 26.10.2006, rreth orës 03:30 në Prishtinë, në lagjen "Dardania", rruga "Bill Klinton", në hotel-bar "Route 66", ai ka sulmuar zyrtarin e policisë së ShPK, personin e lënduar Lulzim Borovci, derisa ky i fundit ka qenë duke kryer detyrat e tij zyrtare në ruajtjen e sigurisë publike, në atë mënyrë që, pasi të pandehurit Tomë Gashi, Avni Zogiani dhe Lorik Pustina kanë hyrë në barin e përmendur më lart dhe për shkak të sjelljes së tyre të keqe ndaj klientëve të tjerë të pranishëm në bar, së pari, në mes tyre kishte filluar një zënkë me fjalë e pastaj një grindje fizike. Me atë rast kishte intervenuar policia dhe derisa ishin duke u munduar t'i ndajnë dhe t'i ndalojnë të përmendurit më lart, i pandehuri Tomë Gashi reagoi në mënyrë të pasjellshme duke britur fjalë sharëse, kërcënuese dhe ofenduese si, "Qifsha nënën e policëve, ju jeni policë të poshtër dhe hajna, do t'ju vras të gjithëve", dhe sulmoi policin/personin e lënduar Lulzim Borovci fizikisht, ka kapur pjesën e epërme të uniformës së tij dhe e ka goditur me dorën e djathtë në fytyrë afër syrit të majtë, dhe i pandehuri Tomë ka rezistuar prangosjen duke kapur dhe shtyer policët me duar, dhe gjatë këtyre veprimeve ata janë rrëzuar në tokë, ku si rezultat i kësaj personi i lënduar i përmendur më lart ka pësuar lëndimet, si hematomë në krahun e majtë, kontuzion në kokë dhe në gjurin e majtë, të kualifikuara si lëndime të lehta trupore që kanë rezultuar në dëmtim të përkohshëm të shëndetit;

- me këtë ai ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, sipas nenit 317, para. 2, lexuar së bashku me para. 1 të KPPK.

I pandehuri Lorik Pustina

2. Në ditën, kohën dhe vendin e njëjtë, siç është përshkruar në paragrafin 1 të dispozitivit të Aktakuzës aktuale, gjatë intervistave të policëve të ShPK mbi grindjen e përshkruar në paragrafin 1, ai ka penguar policët e ShPK-së/personat e lënduar Rreshter Ali Sejdiun, policët Mustafë Tahiraj, Ajet Ajeti, Lulzim Borovci dhe Labinot Ramadani, në kryerjen e

detyrave të tyre zyrtare në ruajtjen e sigurisë publike, në atë mënyrë që, kur është ndaluar nga policia, i pandehuri Lorik Pustina nuk i është bindur urdhrave të policisë, ka ofenduar, sharë dhe kërcënuar gojarisht policët e përmendur më lart, dhe, derisa policët janë munduar ta prangosin, ai ka shtyer dhe kapur për duar dhe rroba këta të fundit, dhe pastaj është prangosur nga policia;

- me këtë ka kryer veprën penale Pengim i personave zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas nenit 316, paragrafi 3, lexuar së bashku me paragrafin 1, dhe nenit 23 të KPPK.

I pandehuri Bekim Mengjiqi

3. Në ditën, kohën dhe vendin e njëjtë, siç është përshkruar në paragrafin 1 të dispozitivit të Aktakuzës aktuale, i pandehuri Bekim Mengjiqi, duke shërbyer në kafe-barin "Route 66", gjatë grindjes së shkaktuar nga të pandehurit Tomë Gashi, Avni Zogiani dhe Lorik Pustina kundër klientëve në kafe-bar siç është përshkruar në dispozitivin aktual, ka intervenuar duke ndërmmjetësuar, por në një moment, pasi është kërcënuar nga i pandehuri Avni, i cili është munduar ta godasë, i pandehuri në fjalë ka goditur të pandehurin Avni me tavëll duhani, mjet i cili mund të shkaktojë lëndim trupor, në pjesën e pasme të kokës, duke i shkaktuar këtij të fundit hematomë në regjionin e qafës, dhe gërvishje në parakrahun e majtë, të cilat janë kualifikuar si lëndime të lehta trupore duke rezultuar në dëmtim të përkohshëm të shëndetit;

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, sipas nenit 153 paragrafi 1, pika 4, të KPPK.

Bazuar në nenin 390, n.3 të KPPK,

Avni Zogiani

Sa i përket veprave penale të listuara më lart shpallet i pafajshëm dhe prandaj lirohet.

Sa i përket arsyeve të përmendura më lart Trupi Gjykues lëshon këtë:

DËNIM

1. Tomë Gashi

Në pajtim me nenin 317, para. 2 të Kodit Penal të Kosovës dënohet me 6 muaj burgim;

2. Lorik Pustina

Në pajtim me nenin 316, para. 3 të Kodit Penal të Kosovës dënohet me 3 muaj burgim;

3. Bekim Mengjiqi

Në pajtim me nenin 153, para. 1 n.4) të Kodit Penal të Kosovës dënohet me gjobë në shumë prej 100.00 euro;

Bazuar në nenin 43 dhe 44 të KPPK dënimet me burgim të caktuara më lart janë me kusht. Trupi Gjykses urdhron që ndëshkimet nuk do të ekzekutohen nëse të dënuarit Tomë Gashi dhe Lorik Pustina nuk kryejnë vepër tjetër penale brenda periudhës një vjeçare.

SHPENZIMET

Në pajtim me nenin 102 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar Tomë Gashi dhe Lorik Pustina duhet të paguajnë shpenzimet e procedurës të përcaktuara për secilin në shumë prej 50.00 euro ndërsa Bekim Mengjiqi do të paguajë shpenzimet e përcaktuara në shumë prej 30.00 euro.

ARSYETIMI

Historiku procedural

Më 19 janar 2007 Prokurori Publik Imer Beka ka ngritur aktakuzë duke akuzuar katër të akuzuarit me akuza të ndryshme, domethënë sulm dhe pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe, respektivisht, lëndim të lehtë trupor.

Aktakuza është konfirmuar përmes vendimit të gjykatëses Allten Murseli më 10 mars 2008, pas dëgjimit të prokurorit, të të akuzuarve dhe avokatëve mbrojtës të të akuzuarve gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës.

Me kërkesën e datës 19 mars 2009, Kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë, Z. Nuhi Uka ka kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që gjykimi kundër të akuzuarve të transferohet në një Gjykatë tjetër. Kërkesa ishte bazuar në argumentin që njëri nga të akuzuarit, Z. Tomë Gashi në të kaluarën ka qenë gjykatës në Gjykatë Komunale dhe aktualisht është avokat me prani të përditshme në Gjykatën e njëjtë, si pjesë e punës së tij. Në kërkesë ishte propozuar që, me qëllim të shmangies nga rreziku i njëanshmërisë, ndërrimi i vendit të mbajtjes së gjykimit do të ishte i përshtatshëm.

Përmes vendimit të datës 27 prill 2009, Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Z. Anton Nokaj kishte deleguar Gjykatën Komunale në Ferizaj të gjykojë rastin.

Më 26 qershor 2010, Kryetari i Gjykatës Komunale në Ferizaj, Z. Rifat Abdullahi, kishte kërkuar nga Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it të caktojë gjykatësit e EULEX-it në këtë rast, duke deklaruar se, për shkak të pozitës së Mr. Tomë Gashit si këshilltar në zyrën e Kryeministrit, rasti duhet të gjykohej nga gjykatësit ndërkombëtar në mënyrë që drejtësia të aplikohet si duhet.

Përmes vendimit të datës 17 shtator 2009, pas seancës dëgjimore të paraparë me nenin 4 të Ligjit mbi Kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve gjykatësve

dhe prokurorve të EULEX-it në Kosovë (L. N. 03/ L-053), Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it i ka caktuar lëndën trupit gjykues të përbërë nga Gjykatës të EULEX-it.

Gjykimi kundër të akuzuarve ka filluar më 14 maj 2010. Pas formaliteteve fillestare dhe leximit të aktakuzës nga prokurori, filloi marrja në pyetje e dëshmitarëve.

Gjykimi u shty për datën 25, 27 dhe 28 maj 2010 për marrje në pyetje të mëtutjeshme të dëshmitarëve dhe të të akuzuarve.

Përpara fillimit të fjalës përfundimtare Prokurori kërkoi leje nga trupi Gjykues të ndryshojë aktakuzën duke thënë si në vijim: *“Dëshiroj të bëj një ndryshim sa i përket kualifikimit të veprës penale të Sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare sipas nenit 317 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK. Dëshiroj të shtoj paragrafin 4. Sa i përket veprës penale Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, neni 316 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1, dëshiroj të shtoj paragrafin 5”.*

Trupi Gjykues në fund dëgjoi fjalët përfundimtare të Prokurorit Publik, të Avokatëve Mbrojtës dhe të të akuzuarve dhe shpalli aktgjykimin gjatë seancës së kaluar.

Konstatimet ligjore dhe faktike.

Aktakuza, në formën e saj origjinale, përpara ndryshimit të kërkuar dhe të lejuar në seancën e kaluar ka gjetur konfirmim substancial në deklaratat e dëshmitarëve dhe në dokumentacionin në dosje.

Me perjashtim të Avni Zogianit, i cili është shpallur i pafajshëm për kryerjen e krimit pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare (neni 316 i KPK), akuzat kundër të akuzuarve të tjerë janë të bazuara.

Ngjarja në të cilën katër të akuzuarit kanë qenë të përfshirë dhe që është përshkruar dhe kualifikuar saktë në aktakuzën origjinale mund të konsiderohet si trazim i vogël i shkaktuar nga një rrethanë specifike, pa ndonjë pasojë të qëndrueshme. Një ngjarje, siç është përshkruar në aktakuzë, që ka zgjatur më pak se një orë dhe që, siç është pranuar nga i akuzuari i njëjtë Gashi¹, përbëhet nga disa minuta marrëzie. *Semel in anno licet insanire.*

Në thelb, gjatë gjykimit janë dhënë dy pasqyrime të ngjarjes.

Në njërën anë, policët që kishin arritur në vendin e ngjarjes kanë deklaruar se ishin sulmuar nga Tomë Gashi derisa ishin duke shoqëruar Lorik Pustinën dhe Avni Zogianin për në stacionin policor, ndërsa i akuzuari Tomë Gashi dhe Lorik Pustina kanë pohuar se fare nuk ka pasur sulm nga ana e Tomë Gashit dhe se, përkundrazi, ishte policia ajo që kishte reaguar në mënyrë të tepërt dhe kishte përdorur forcë të tepëruar kundër Tomë Gashit kur ky i fundit kishte pyetur për arsyen se përse Lorik Pustina ishte duke u shoqëruar për në stacionin policor.

¹ Procesverbali i seancës së 25 majit 2010, fq.

Të vazhdojmë sipas rendit dhe të marrim parasysh zhvillimin e fakteve ashtu sikurse që janë përshkruar nga dëshmitarët dhe i akuzuari i njëjtë.

Është e pa kontestuar se në orët e hershme të 26 tetorit 2006, Tomë Gashi, Lorik Pustina dhe Avni Zogiani kanë qenë në restorantin Rute 66 në Dardani. Nuk kontestohet se Bekim Mengjiqi ka qenë gjithashtu në restorant si kamerier.

Në deklaratat² e personave që kanë qenë të pranishëm në restorant (Dren Hajzeri, Veton Halili, Petrit Dushi dhe Kastriot Berisha) janë përshkruar me qartësi sjelljet shqetësuese dhe arrogante të Tomë Gashit, Lorik Pustinës dhe Avni Zogianit të cilët kanë folë me zë të lartë dhe kanë përdorë fjalë të pahijshme, duke shkaktuar siklet dhe duke i shqetësuar klientët tjerë të restorantit. Këta të tre (të cilët kanë qenë në shoqëri të një avokati amerikan, Z. Gregory Guy Smith) kanë bërë turr duke folur fjalë vulgare dhe të këqija; kur nga ata është kërkuar nga një klient tjetër i restorantit që të sillen mirë, Avni Zogiani ka reaguar ashpër. Në atë moment situata ka dalë jashtë kontrollit dhe ka filluar konfrontimi në mes të këtij mysafiri të restorantit dhe Avni Zogianit me intervenim të një apo më tepër kamerierëve të restorantit të cilët janë munduar që ti ndajnë pjesëmarrësit.

Në këtë përleshje, Bekim Mengjiqi e ka qëlluar Avni Zogianin me një shpuzore. I akuzuari dikur e ka pranuar këtë veprim të vetin gjatë marrjes së tij në pyetje³, me arsyetim se është dashtë që ti rezistojë agresionit nga i akuzuari Zogiani. Afërsia e Bekimit ndaj vendit të ngjarjes dhe përdorimi i shpuzores nga ai, përmenden në deklaratën e Kastriot Berishës dhanë prokurorit me datën 1 nëntor 2006.

Ajo çka ka ngjarë mandej (reagimi i Avni Zogianit, ikja e Bekim Mengjiqit, arritja e policisë, kontrollimi dhe zbulimi i personit i cili kishte ikur dhe fshihej prapa restorantit) gjithashtu nuk kontestohet.

Pas arritjes së policisë, situata është keqësuar edhe më tepër. Në bazë të deklaratave të dëshmitarëve të lartpërmendur që përputhen, Avni Zogiani dhe Tomë Gashi kanë insistuar që policia ta ndjekë personin i cili e ka qëlluar Avni Zogianin, me ton arrogant dhe provokues (dëshmitari Veton Halili, deklarata e 2 nëntorit 2006 "Tomë Gashi ka thënë "A e dini se kush jam unë...?", Petrit Dushi, deklarata e 1 nëntorit 2006: "Tomë Gashi...është ndarë nga ne dhe shkoi që të grindet me policinë, ma arrogant në fillim ka qenë Avni Zogiani i cili na drejtohej neve punëtorëve të restorantit me fjalët: "Ju jeni të vdekur"). Paaftësia e dy të akuzuarve (Gashit dhe Zogianit) për të kontrolluar veten është vërtetuar prej momentit të parë që kishte mbërrirë policia. Kjo gjendje e zemërimit dhe e shqetësimit gjithashtu vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve tjerë në gjykim dhe nga deklaratat (e lexuara ex n. 368.1, n.3 KPPK) që janë dhanë në prokurori dhe policisë nga ana e Dren Hajzeri, Veton Halili, Petrit Dushi dhe Kastriot Berishës.

Çka ka qenë shkak i shqetësimeve dhe armiqësimeve të tepruara që ka ndikuar te të tre të akuzuarit (Lorik Pustina, Tomë Gashi dhe Avni Zogiani)? Pa dyshim se sulmi ndaj

² Deklaratat që mund të përdoren si prova pas marrjes së vendimit të Trupit gjyqësor gjatë dëgjimit me 27 maj 2010 ex n. 368. 1 n.3).

³ Dëgjimi i datës 27 maj 2010, faqe17.

Avni Zogianit i ka kontribuar këtij shkak. Por ka edhe gjërat tjera. Oficerët e policisë që kanë intervenuar kanë pohuar se këta të tre kanë konsumuar alkool dhe edhe pse njëri nga ata përdorë fjalë kujdesi (Lulzim Borovci, procesverbali nga dëgjimi më 14 maj 2010), të tjerët nuk hezitojnë që ta thonë këte në lidhje me Lorik Pustinën dhe Tomë Gashin (Labinot Ramadani, faqe 16; Çajup Selaci, fq. 29 dhe 31). Nga ana tjetër, atë se Lorik Pustina nuk ka qenë esëll vërtetohet nga vet i akuzuari në deklaratën e tij të dhënë në polici në ora 04:37 të datës 26 tetor 2006, ku edhe e ka shprehë dëshirën që të jep versionin e vet një herë tjetër, pasi që ka qenë tepër i lodhur dhe nën ndikimin e alkoolit për ta bërë këtë disa orë pasë ngjarjes.

Por, ekziston diçka më tepër. Për të shpjeguar sjelljen agresive të Tomë Gashit kontribuon gjithashtu karakteri i tij, domethënë profili psikik-social specifik i të akuzuarit. Ky avokat ka treguar një lloj paaftësie që të kontrollojë veten kur është nën presion, një karakteristikë që gjithashtu ka ardhur në shprehje gjatë gjykimit, kur Kryetari i Trupit Gjykes duhej vazhdimisht⁴ ta thirrte që të sillet si duhet dhe të kontrollojë veten. Kjo është një tendencë që të merr një pozitë dominuese, edhe kur kjo nuk është e nevojshme dhe është tërësisht pa vend; një këmbëngulje e tepërt që rrezikon të bëhet kundër-produktive. Një karakteristikë e personalitetit të Gashit që reflektohet me shprehjet e avokatit të përdorura kundër forcave të policisë herret në mëngjes më 26 tetor 2006. Shprehjet si “ju nuk e dini se kush jam unë”, “unë jam njeri i Ramushit (domethënë i Haradinajt)”, “Unë do të vi me kallashnikov, do të vejë bombat në stacionin e policisë”, “çfarë lloj policësh jeni ju, ju duhet të shkoni dhe të shitni xhinsat në Bullgari” shprehin një përzjerje e tregimit të forcës, arrogancës, paturpësisë dhe kundërshtimit të hapur që vështirë shkon mirë me profesionin e Tomë Gashit. Një sjellje që i akuzuari Tomë Gashi ka përsëritur më vonë në spital (cfr. Deklarata e Selman Rexhepit, e datës 1 nëntor 2006, faqja 2; dhe dëshmitarit Ali Sejdiu, dëgjimi i datës 14 maj 2010, faqe 26) dhe në stacionin e policisë.

Pra, është vërtetuar se edhe pas ardhjes së policisë situata ishte e tensionuar dhe se intervenimi i personave zyrtar nuk ishte i mjaftueshëm që të qetësohet.

Çka ndodhi pastaj?

Këtu deklaratat ndryshojnë: në një anë janë oficerët e policisë që raportojnë agresionin e Tomë Gashit dhe rezistencën e dy tjerëve; në anën tjetër janë versionet e të akuzuarve që fajësojnë përdorimin e tepërt të forcës nga policia dhe mbështetjen në dhunë nga ana e policëve (veçanërisht të Lulzim Borovcit dhe Ajet Ajetit) gjatë arrestimit.

Si përfundim, sjellja e Avni Zogianit, sikur që përshkruhet nga oficerët, nuk mund t'i shtohet rezistencës së përshkruar në aktakuzë: vërtetë, ai ka bërë titur dhe ka sharë oficerët që nga fillimi, duke i pyetur se përse nuk e ndjekin personin që i ka mëshuar atij me shpuzore dhe ka ikur kah dera e pasme (dëshmia e Dren Hajzerit, Petrit Dushit) por

⁴ Dëgjimi 27 maj 2010, faqe 9.

pastaj, kur ai kuptoi se i dyshuari veç ka qenë i përcjellë nga policia në stacionin policor të jugut, ai ka përcjellë oficerët e policisë pa rezistencë⁵

Sjellja e Lorik Pustinës nuk mund të përshkruhet me të njëjtin kuptim. Kundërshtimi i tij që të përcillet në Stacionin e Policisë është konfirmuar nga Lulzim Borovci⁶, Labinot Ramadani⁷. Ai ka kundërshtuar kur Avni Zogiani u përcjellë në stacionin e policisë dhe kur Tomë Gashi ka filluar grindjen me oficerët e policisë, kështu që ka qenë e nevojshme që ai të prangoset.

Lidhur me Tomë Gashin ka mbetur pak të thuhet. Të gjithë oficerët e policisë së dëgjuar gjatë gjykimit si dhe dëshmitarët tjerë të dëgjuar gjatë hetimeve përshkruajnë agresivitetin e kotë të akuzuarit ndaj policisë dhe refuzimin e tij ndaj ekzekutimit të detyrave zyrtare. Nga kjo dhunë e tepërt verbale, i akuzuari ka kaluar në dhunën fizike kur ka kuptuar se të gjitha tentimet e tija që të ndalin transportin e Lorik Pustinës deri në stacionin e policisë kanë qenë të kota.

Tomë Gashi ka pohuar se ai ishte viktimë e oficerëve të policisë. Tani, që oficerët e policisë e kishin sulmuar Tomë Gashin dhe jo e kundërta, nuk është e besueshme. Është një version i pakuptimtë që duhet të shikohet si një tentim i thjeshtë për shmangie nga përgjegjësia penale.

Pse do ta kishin ba ata këtë? Oficerët e policisë kanë qenë nën kontroll të situatës deri atëherë, ata kanë qenë në një numër shumë më të madh se sa sulmuesi, ata nuk kanë pasur asnjë arsye personale që të sulmojnë Tomë Gashin. Gjatë gjykimit Tomë Gashi tentoi të fajësojë oficerët e policisë në mënyra të ndryshme: dëshmitarin Ali Sejdiu, ai ka kontestuar besueshmërinë e tij në bazë të një episode që ka kaluar moti⁸ të mohuar nga dëshmitari; ai pretendonte se oficerët e policisë e kanë sulmuar për shkak se ata i kanë takuar një grupi ("FURK"?) dhe veçanërisht njëri sepse ai ishte nga Drenica dhe kundër Haradinajt....

Shumë pretendime konfuze, që nuk kanë baza dhe besueshmëri, nëse asgjë tjetër sepse të gjithë oficerët e policisë kanë mohuar se dinin se ka ndodhur kjo episode me Tomë Gashin përpara 26 tetorit.

⁵ Labinot Ramadani, dëgjimi 14 maj 2010, faqe 16 : "Ka pasur britmë; një i ri ka kërkuar personat që e kanë sulmuar dhe nuk mërzitej nëse policia ka qenë aty apo jo. Unë i thash se personi që e ka sulmuar ishte në stacionin e policisë; kështu që, rrugës për në stacionin e policisë, ai erdhi pa problem dhe pa pranga në dorë"

Mustafë Tahiraj, faqe 21 : "Kryetari i Trupit Gjykses: ... sjellja e Avni Zogianit? Mustafë Tahiraj: Në atë moment ai ka qenë agresiv". Ali Sejdiu, faqe 26: "Unë nuk mund të kujtojë detajet. E di se ai nuk ka rezistuar. Sikur ta kishte bërë këtë ne do ta kishim prangosur. Ne e kemi përcjellë; dy prej neve, një oficer i policisë dhe unë e kemi përcjellë rrugës deri te stacioni i policisë. Unë kisha thënë kushtimisht se ai ishte pak agresiv pasi që ka qenë i sulmuar".

⁶ Lulzim Borovci, faqe 8: E di se Lorik Pustina ka treguar një pengesë arrestimit ose përcjelljes së Avni Zogianit, ai nuk ka lejuar personit zyrtar që ta mbajë Avni Zogianin dhe ta përcjellë deri në stacionin e policisë. Kjo është kur mbikëqyrësi im ka kërkuar ndihmën time pasi që ai nuk ka qenë i lejuar që të kryej detyrat e tija. Kjo është pse unë kam qenë i izoluar me Lorik Pustinën kur kam hasur në personin tjetër".

⁷ Labinot Ramadani, faqe.14: "Aty ishte kaosi në mes të kolegëve tjerë dhe Tomë Gashit dhe Lorik Pustinës. Mua më ka ndihmuar kolegu nga njësia e trafikut dhe ne së bashku e prangosëm Lorikun i cili më vonë hezitoi që të përcillet deri në stacionin e policisë".

⁸ Procesverbal 14 maj 2010, faqe 27: Tomë Gashi: A ju kam gjykuar unë për sjellje të keqe të tepërt të abuzimit të fuqisë si oficer i policisë si një polic i Jugosllavisë në vitet e 90a? Ali Sejdiu: As ju ose askush kurrë nuk më ka gjykuar për asnjë sjellje të keqe, asnjëherë. Asnjëherë asnjë dosje nuk është hapur për mua.

Në bazë të gjatësisë të gërvishtjeve në fytyrën e tij (sikur që u dokumentua në fotografinë në dosje), i akuzuari Gashi ka tentuar të argumentojë se dëmi i tillë fizik nuk mund të prodhohet thjeshtë duke u rrezuar në trotuar dhe se një veprim i mëtutjeshëm duhet të ishte shkak i kësaj. Kjo, ai tha, përgënjeshtro versionin e oficerëve të policisë, se ai nuk ishte i maltretuar kur ishte i shtrirë për tokë dhe e konfirmon versionin e tij, se kur ishte në tokë, një polic e ka shkelë fytyrën e tij para se ta prangoste.

Nuk ekziston asnjë element, përtej këtij argumenti dhe dëshmisë së Tomë Gashit dhe Lorik Pustinës, që e vërteton versionin e avokatit. Për më tepër, edhe nëse ka qenë e vërtetë (gjë që nuk është pranuar nga Trupi Gjykes, pasi që nuk ka prova të mjaftueshme, sikur që u tha) do të kishte me qenë jo relevante që të vërtetohet vetë mbrojtja ose një mbrojtje e bazuar në dispozitat e paragrafëve të fundit të neneve 316 dhe 317 të KPP, sikur që u kërkuar nga prokurori me aktakuzën e ndryshuar (procesverbali i dëgjimit të fundit, 28 maj 2010, pjesa fillestare).

Sidoqoftë, mbrojtja e nevojshme (neni 8 KPP) dhe heqja dorë nga dënimi i parashikuar me nenin 316.5 KPP kërkon që veprimi i të akuzuarit (i cili përbën mbrojtjen e paraparë me nenin 8 ose sulmin e paraparë me nenin 316.5 KPP) është bërë për të larguar sulmin e pashmangshëm (neni 8) ose për të u përgjigjur ndaj një provokimi (neni 316.5), domethënë kur agresioni i paligjshëm mbi jetën e të akuzuarit (mbrojtja e nevojshme) ose nderi (neni 316.5) është duke u penguar ose veç është kryer.

Në të dyja rastet, reaksioni i të akuzuarit bëhet i justifikueshëm me sulmin që ka paraprirë, kështu që do të ishte e panatyrshme dhe do të ishte perceptuar si dënim jo i drejtë.

Por në rastin konkret, edhe nëse e pranojmë versionin e Gashit, veprimi i cili pretendohet se ka shkaktuar plaga në fytyrën e të akuzuarit ka qenë në vazhdim të agresionit të Tomë Gashit dhe nuk i ka paraprirë atij. Për këtë arsye, mekanizmi i mbrojtjes së nevojshme ose heqja dore nga dënimi nuk mund të luajnë rolet e tyre gjegjëse.

Për shkak të arsyeve të sipërme, i akuzuari Tomë Gashi, Lorik Pustina dhe Bekim Mengjiqi janë gjetur fajtorë për krimet me të cilat ata janë ngarkuar në aktakuzë, ndërsa Avni Zogiani nuk është gjetur fajtor.

Disa fjalë lidhur me dënimin.

Sikur që është parë, Tomë Gashi është përgjegjës për kryerjen e veprës penale të sulmit ndaj personit zyrtar që kryen detyrën zyrtare. Më saktësisht, kemi të bëjmë me paragrafin 2 të nenit 317 të KPP, pasi që vepra ka rezultuar në lëndim të lehtë trupor ndaj oficerit policor Lulzim Borovci, sikur që kërkon dispozita dhe është vërtetuar me dokumentacionin mjekësor në dosjen e lëndës dhe me dëshmitë e vet viktimës dhe të kolegëve të tij.

Dënimi minimal i paraparë me ligj është gjashtë muaj. Për shkak të ngjarjes dhe rrethanave specifike të cilat kanë çuar deri në këtë, dënimi i caktuar ndaj të akuzuarit

Tomë Gashi është kufizuar deri në minimum. Në anën tjetër, nuk ka arsye që të pranohen rrethanat lehtësuese: ende në Gjykatë, i akuzuari nuk ka treguar pendimin për atë që ka bërë, ende i bindur se është në anën e drejtë.

Lorik Pustina është përgjegjës për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare. Më saktësisht, kemi të bëjmë me paragrafin 3 të nenit 316 të KPK, pasi që vepra është kryer kundër një zyrtari që kryen detyrat e tij të mirëmbajtjes së rendit publik, sikur që kërkohet me dispozitë dhe nënkuptohet në rrethanat e ngjarjes.

Dënimi minimal i paraparë me ligj është tre muaj. Për shkak të ngjarjes dhe të rrethanave specifike që kanë çuar deri në këtë, dënimi i caktuar ndaj të akuzuarit Lorik Pustina është kufizuar deri në minimum. Në anën tjetër, nuk ka arsye të pranohen rrethanat lehtësuese: pasi që në rastin e Tomë Gashit, i akuzuari nuk ka treguar pendim për atë që ka bërë, ende i bindur se është në anën e drejtë.

Në bazë të nenit 43 dhe 44 KPK, dënimet me burgim të caktuara më lartë janë me kusht. Trupi Gjykses urdhëron që dënimet të mos ekzekutohen nëse të dënuarit Tomë Gashi dhe Lorik Pustina nuk kryejnë një vepër tjetër penale brenda një periudhe prej një viti.

Bekim Mengjiqi ka shkaktuar një lëndim të lehtë trupor te Avni Zogiani, në kuptim të nenit 153.1, n. 4 KPK. Një dënim prej 100,00 euro është dënim me vend për shkeljen e lehtë të kryer.

SHPENZIMET

Në bazë të nenit 102 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar Tomë Gashi dhe Lorik Pustina do të paguajnë shpenzimet e procedurës të caktuar prej 50.00 eurove secili ndërsa Bekim Mengjiqi do të paguaj shpenzimet e caktuara prej 30.00 eurove.

Data: 28 maj 2010

Kryetari i Trupit Gjykses
Francesco Florit

Anëtare e Trupit Gjykses
Shadije Gërguri

Anëtar i Trupit Gjykses
Ferdinando Buatier de Mongeot

Procesmbajtësi
Eriona Bitri-Brading